



KOMUNA E PRIZRENIT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

## UDHËZUES PËR APLIKANTË 2024

---

### Skema e Granteve „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe Start-Up në komunën e Prizrenit“

Financuar nga Komuna e Prizrenit, në bazë të vendimit Nr. 01/238/24 të datës  
28.03.2024, bazuar në MoU në mes të komunës së Prizrenit dhe AZHR Jug 01/217/24,  
të datës 22.03.2024

Autoriteti kontraktues  
(Në emër të komunës së Prizrenit):  
Agjencia për Zhvillim Rajonal - Jug  
(AZHR Jug)

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve:  
6 qershor 2024, ora 16:00



**KOMUNA E PRIZRENIT**  
**OPSTINA PRIZREN**  
**PRIZREN BELEDIYESI**  
**MUNICIPALITY OF PRIZREN**



**AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG**  
**REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG**  
**BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY**  
**REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH**

## **Përmbajtja**

1.	Skema e granteve „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit“ .....	3
1.1.	Hyrje .....	3
1.2.	Skema e granteve „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit“ .....	3
1.3.	Synimet e Thirrjes për Propozime (ThpP) .....	4
1.4.	Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues .....	4
1.5.	Shumat e grantit .....	4
2.	Rregullat e ThpP .....	4
2.1.	Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë? .....	5
2.2.	Aplikantët që nuk kualifikohen .....	5
2.3.	Projektet e kualifikueshme .....	5
2.4.	Sektorët apo temat .....	5
2.5.	Lokacioni .....	6
2.6.	Llojet e projekteve .....	6
2.7.	Kualifikueshmëria e shpenzimeve .....	6
3.	Si të aplikohet dhe procedurat që duhet ndjekur .....	7
3.1.	Formulari i aplikimit .....	7
3.2.	Ku dhe si të dërgohet Pakoja e Aplikimit .....	8
3.3.	Afati për dorëzimin e aplikacioneve .....	9
3.4.	Orari indikativ për këtë skemë .....	9
4.	Kriteret e Vlerësimit .....	9
5.	LISTA E SHTOJCAVE .....	10



KOMUNA E PRIZRENIT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

## **1. Skema e granteve „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit“**

### **1.1. Hyrje**

Komuna e Prizrenit tradicionalisht njihet si një qendër me zejтари dhe industri të lehtë të zhvilluar, ku sektorët kryesorë ekonomik janë industria përpunuese e ushqimit, tekstilit, drurit dhe metalit. Ajo është e njohur edhe si qendër kryesore turistike në Kosovë.

Prizreni dallohet me trashëgiminë e pasur kulturo-historike dhe traditën e lashtë të tolerancës dhe bashkëpunimit ndëretnik, prandaj edhe konsiderohet si qyteti më heterogjen i Kosovës në aspektin etnik.

Asetet e shumta natyrore dhe të trashëgimisë kulturore e historike e bëjnë Prizrenin vendin më tërheqës në Kosovë, si për turistët vendas, ashtu edhe për ata të jashtëm. Përderisa në të kaluarën Prizreni ishte simbol i zejtarisë, gjatë dy dekadave të fundit prioritet i është dhënë zhvillimit të industrisë së lehtë përpunuese dhe turizmit, sektorë të cilët punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në gjysmën e dytë të vitit 2023 në nivel të komunave, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mbizotëron komuna e Prishtinës me 2541 ndërmarrje të regjistruara (30.79%); pason Ferizaj me 763 ndërmarrje të regjistruara (9.25%); kurse Prizreni ka 669 ndërmarrje të regjistruara (8.11%) në këtë periudhë.

Përqindja më e madhe e bizneseve, si në Prizren, po ashtu edhe në nivel të Kosovës, janë biznese familjare (mikro), të cilat japin kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit.

### **1.2. Skema e granteve „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit“**

Komuna e Prizrenit në bashkëpunim me AZhR Jug, me lansimin e skemës së granteve për përkrahjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up do të ndihmojë në stimulimin e hapjes së bizneseve të reja, si dhe në zgjerimin dhe diversifikimin e tyre. Në këtë mënyrë do të ndikohet edhe në motivimin e të rinjve që të ardhmen e tyre ta shohin në vendin tonë, ku po ashtu ka potencial për zhvillim dhe sigurim të të ardhurave solide.

Me këtë skemë të granteve do të përzgjidhen idetë më inovative dhe më unike të ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up të komunës së Prizrenit, të cilat me këto grante do të jenë në gjendje të krijojnë kushte më të mira për rritjen e të hyrave, hapjen e vendeve të reja të punës, zvogëlimin e importit dhe rritjen e eksportit.



KOMUNA E PRIZRENT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

### 1.3. Synimet e Thirrjes për Propozime (ThpP)

**Synimi i përgjithshëm** i ThpP është krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të reja dhe të atyre ekzistuese në komunën e Prizrenit.

**Synimet specifike** të kësaj ThpP janë:

- i. Krijimi i vendeve të reja të punës
- ii. Rritja e eksportit dhe zvogëlimi i importit;

### 1.4. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme në dispozicion për këtë thirrje është 60,000 €. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet.

Granti do të ndahet në dy Lot-e:

Lot 1 – Start-Up.....20,000 Euro

Lot 2 – Ndërmarrjet ekzistuese.....40,000 Euro

### 1.5 Shumat e grantit

Shumat e grantit sipas Lot-eve ndahen në:

Lot 1 - Vlera minimale e një granti është 500.00 €, ndërsa vlera maksimale është 2,000.00 €.

Lot 2 - Vlera minimale e një granti është 2,000.00 €, ndërsa vlera maksimale është 4,000.00 €.

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët për Lot 1 duhet të jetë minimum 10% dhe maksimum 49%, ndërsa për Lot 2 duhet të jetë minimum 20% dhe maksimum 49%. Kontributi në natyrë nuk konsiderohet bashkëfinancim. Shuma e grantit që kërkohet nga Autoriteti Kontraktues duhet të jetë minimum 51% dhe maksimum 90% e vlerës së përgjithshme të projektit për Lot 1, përkatësisht maksimum 80% e vlerës së përgjithshme të projektit për Lot 2.

## 2. Rregullat e ThpP

Ky udhëzues përcakton rregullat për përpilimin, dorëzimin, përzgjedhjen dhe implementimin e projekteve të financuara sipas kësaj ThpP. Ekzistojnë tri tërësi të kriterëve për kualifikim:

1. Aplikanti që mund të kërkojë grant;
2. Veprimet (lloji i projektit) për të cilat mund të jepet granti;
3. Llojet e shpenzimeve të lejuara.



KOMUNA E PRIZRENTIT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

## ***2.1 Kualifikimi i aplikantëve: kush mund të aplikojë?***

Për t'u kualifikuar për aplikim për grant, aplikanti/ja duhet:

- Të jetë shtetas i Kosovës dhe banor rezident i komunës së Prizrenit (dëshmohet me kopjen e letërnjoftimit)
- Të mos ketë biznes të regjistruar (për Lot 1)
- Të jetë biznes mikro (deri 9 punëtorë), sipas legjislacionit ekzistues në Kosovë (Lot 2)
- Të ketë qarkullim për vitin e kaluar kalendarik minimum 3,000 EUR dhe maksimum 100,000 EUR (Lot 2)
- Të mos ketë obligime të pashlyera tatimore (Lot 2)
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës/e për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit.

## ***2.2 Aplikantët që nuk kualifikohen***

Aplikantët potencialë që nuk mund të marrin pjesë në ThpP janë të renditur si një vijim:

- Është shërbyes civil ose mbanë pozitë politike në ndonjë nga institucionet lokale ose qendrore të Kosovës.
- Është banor/biznes nga ndonjë komunë tjetër.
- Ka qenë përfitues i thirrjeve të komunës së Prizrenit gjatë viteve 2022 dhe 2023.
- Ata/Ato që janë dënuar për një vepër që ka të bëjë me sjelljen profesionale me aktgjykim të një autoriteti kompetent.
- Ata/Ato që kanë qenë subjekt i një aktgjykimi të prerë e të plotfuqishëm për mashtrim, korrupsion, përfshirje në organizatë kriminale, shpëlarje të parave apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm, ku aktiviteti i tillë i paligjshëm është dëmtues për interesat financiarë të Kosovës.

## ***2.3 Projektet e kualifikueshme***

### Definicioni:

Projekti përbëhet nga një tërësi aktivitësh.

### Kohëzgjatja:

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit që financohet nga komuna e Prizrenit, nuk mund të tejkalojë periudhën kohore prej 6 muaj (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

## ***2.4 Sektorët apo temat***

Aplikimi mund të bëhet në fushat e prodhimit dhe përpunimit të produkteve dhe në sektorin e shërbimeve. Përparësi do të kenë projektet nga sektori i IT-së, tekstilit, përpunimit të drurit dhe metalit. Projektet nga sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë, agrikulturës, gastronomisë,



KOMUNA E PRIZRENIT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

shëndetësisë, shërbimeve administrative (kontabilitet, gjeodezi, etj.), sportit dhe kulturës **nuk janë të pranueshme.**

### *2.5 Lokacioni*

Projekti duhet të realizohet në territorin e komunës së Prizrenit.

### *2.6 Llojet e projekteve*

Projektet duhet të kenë ndikim të preکشëm dhe të dukshëm tek ndërmarrjet ekzistuese dhe ato Start-Up në krijimin e kushteve për rritjen e biznesit dhe në rritjen e punësimit. Si **shpenzim i pranueshëm** me këtë thirrje konsiderohet vetëm blerja e makinerisë dhe pajisjeve të nevojshme.

#### **Llojet vijuese të projekteve NUK kualifikohen:**

- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca, paga dhe mëditje;
- Veprimet që kanë të bëjnë vetëm me apo kryesisht me bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Programet për kredi;
- Veprimet operative që nuk lidhen me implementimin e projektit;
- Aktet që shkelin rregullat dhe rregulloret e njohura ndërkombëtarisht të cilat mbrojnë të drejtat e punëtorëve në Kosovë.

Projekti duhet të jetë në përputhje me objektivat dhe prioritetet e Thirrje për Propozime (ThpP) dhe të garantojë dukshmërinë e financimit nga komuna e Prizrenit dhe AZHR Jug (udhëzimet do të merren para nënshkrimit të kontratës).

#### Numri i aplikimeve për aplikant

Një aplikant **mund të dorëzojë vetëm një aplikacion** në këtë ThpP.

### *2.7 Kualifikueshmëria e shpenzimeve*

Shpenzimet e planifikuara duhet të jenë në përputhje me rregullat e përcaktuara me këtë thirrje. Kostot e kualifikueshme duhen bazuar në shpenzime reale të tregut.

#### Shpenzimet e kualifikueshme janë (të dëshmuara me ofertë/profaturë):

- Blerja e makinerisë dhe pajisjeve të nevojshme (të reja/të papërdorura);
- Janë shënuar saktë në buxhetin e përgjithshëm të projektit;
- Janë të domosdoshme për implementimin e projektit;
- Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme, të regjistruara në regjistrat e kontabilitetit të aplikuesit;
- Janë të arsyeshme, të arsyetuara brenda kërkesave të menaxhimit të qëndrueshëm financiar, sidomos në lidhje me ekonomizimin dhe efikasitetin.



KOMUNA E PRIZRENT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

### Shpenzimet e pakualifikueshme:

Kostot vijuese nuk janë të pranueshme:

- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Pajisjet e përdorura;
- Pagat dhe mëditjet;
- Shpenzimet e lëndës së parë dhe repromaterialit,
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji, etj.)

Shpenzimet e papranueshme janë çështje e përfituesit, prandaj ato nuk duhet të përfshihen në kërkesën për pagesë, kështu që përfituesi duhet të ketë mjete financiare vetanake për mbulimin e tyre.

**TVSH-ja është shpenzim i pranueshëm vetëm për Lot 1 dhe për bizneset që nuk janë deklarues të TVSH-së.**

### **3. Si të aplikohet dhe procedurat që duhet ndjekur**

#### ***3.1 Formulari i aplikimit***

Aplikantët duhet ta plotësojnë **Formularin e Aplikimit** të ofruar nga Autoriteti Kontraktues, së bashku me **Buxhetin e Projektit, Projektionin Financiar dhe Deklaratën e Aplikantit**, të bashkëngjitur në këtë pako aplikimi. Aplikantët duhet t'i përmbahen saktë formatit të formularit të aplikimit dhe të gjitha anekseve të poshtëshënuara dhe të plotësojnë secilin paragraf dhe faqe me rend.

i) Pako aplikimi

**Shtojca A1 - Formulari i aplikimit Lot 1**

**Shtojca A2 - Formulari i aplikimit Lot 2**

**Shtojca B - Buxheti**

**Shtojca C1 - Projektioni financiar Lot 1**

**Shtojca C2 - Projektioni financiar Lot 2**

**Shtojca D - Deklarata me shkrim nga aplikanti**

Dokumentet tjera të nevojshme për aplikim janë:

- Kopja e letërnjoftimit të pronarit/aplikantit
- Oferta/Profatura për blerjen e pajisjeve
- Certifikata e regjistrimit të biznesit me të gjitha fletat përcjellëse (vetëm për Lot 2)



KOMUNA E PRIZRENIT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

- Vërtetimi tatimor që aplikanti nuk ka obligime të pashlyera, ose që ka marrëveshje me ATK-në për shlyerjen e borxhit (jo më i vjetër se data e shpalljes së skemës së ThpP, vetëm për Lot 2).
- Pasqyra e të ardhurave nga ATK për vitin 2023 (vetëm për Lot 2)
- Lista e punëtorëve nga ATK për vitin 2023 (vetëm për Lot 2)

Vërtetimi nga Gjykata Komerciale e Kosovës që përfituesi/ja nuk është në falimentim (jo më i vjetër se data e shpalljes së skemës së ThpP, vetëm për Lot-2), së bashku me dëshminë e llogarisë bankare aktive dhe garancionin bankar për shumën e grantit të pranuar, duhet të sillen para nënshkrimit të kontratës dhe nuk janë pjesë e pakos së aplikimit. Për blerjet të cilat realizohen jashtë vendit duhet të bashkëngjitet edhe Dokumenti Unik Doganor (kopje identike me origjinalin e nënshkruar dhe vulosur nga përfituesi) nga Dogana e Republikës së Kosovës.

Të gjitha shtojcat e aplikimit mund të shkarkohen nga uebfaqja e komunës së Prizrenit <https://kk.rks-gov.net/prizren> si dhe në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram të AZHR Jug, në linqet: <https://www.facebook.com/azhrjug> dhe [azhrjug/rdasouth](https://www.instagram.com/azhrjug). Aplikacionet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, boshnjake dhe turke.

### **Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.**

Vetëm formularët e **PLOTËSUAR** të aplikimit dhe shtojcat do të kalojnë për vlerësim. Kështu, është me rëndësi kyçe që këto dokumente të përmbajnë **TË GJITHA** informatat relevante në lidhje me projektin.

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë kontrollin administrativ, kontrollin e kualifikueshmërisë dhe vlerësimin final. Procesi i kontrollit teknik do të vërtetohet nëse aplikuesi ka paraqitur dokumentet e kërkuara me këtë udhëzues dhe nëse ai/ajo ka respektuar kriteret e kualifikueshmërisë, ndërsa vlerësimi final do të kryhet në bazë të kriterëve të caktuar për vlerësim. Grantet do t'u jepen aplikantëve me pikët më të larta, deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

Komuna e Prizrenit dhe AZHR Jug nuk janë përgjegjëse për koston që ndërlihet me përgatitjen e aplikacionit.

### **3.2 Ku dhe si të dërgohet Pakoja e Aplikimit**

Aplikacioni duhet dorëzuar në e-mail adresën në vijim: [azhr.jug.info@gmail.com](mailto:azhr.jug.info@gmail.com).

Aplikacionet e dërguara me mjete të tjera (fax, personalisht të shtypura apo me postë), ose dorëzuar në adresat e tjera do të refuzohen.

Pakaja e plotë e aplikimit (të gjitha shtojcat) duhet dorëzuar në formatin PDF. Në subjektin e emailit duhet ta shkruhet titulli i ThpP: „Mbështetja e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit 2024“ .





KOMUNA E PRIZRENT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

### 3.3 Afati për dorëzimin e aplikacioneve

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 6 qershor 2024, në ora 16:00, siç vërtetohet me anë të datës së pranimit në e-mail.

### 3.4 Orari indikativ për këtë skemë

Vendi	Data	Ora/Vendi
Lansimi i skemës - Zyra e Kryetarit	10 maj 2024	10:00
Sesioni informues – salla e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardhë)	15 maj 2024	10:00 – 12:00
Afati i fundit për parashtrimin e pyetjeve nga aplikantët	27 maj 2024	16:00
Publikimi i përgjigjeve për aplikantët	30 maj 2024	<a href="https://kk.rks-gov.net/prizren">https://kk.rks-gov.net/prizren</a> , <a href="https://www.facebook.com/azhrjug">https://www.facebook.com/azhrjug</a>
Afati i fundit për aplikim	6 qershor 2024	16:00
Shpallja preliminare e fituesve	20 qershor 2024	<a href="https://kk.rks-gov.net/prizren">https://kk.rks-gov.net/prizren</a> , <a href="https://www.facebook.com/azhrjug">https://www.facebook.com/azhrjug</a>
Afati i fundit për ankesa	27 qershor 2024	16:00
Shpallja e listës së përfituesve dhe nënshkrimi i kontratave	30 qershor 2024	Zyra e kryetarit

Pyetjet eventuale mund të dërgohen në emailin vijues: [azhr.jug.info@gmail.com](mailto:azhr.jug.info@gmail.com), më së voni deri më 27 maj 2024 në ora 16:00, ndërsa ankesat e aplikantëve mund të dorëzohen në emailin e mësipërm, deri më 27 qershor 2024, ora 16:00. Autoriteti kontraktues nuk ka obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas kësaj date.

## 4. Kriteret e Vlerësimit

Tabela e mëposhtme paraqet fushat kryesore të kriterëve të vlerësimit që do të përdoren nga komisioni vlerësues për të përzgjedhur aplikantët e suksesshëm.



KOMUNA E PRIZRENT  
OPSTINA PRIZREN  
PRIZREN BELEDIYESI  
MUNICIPALITY OF PRIZREN



AGJENCIA PËR ZHVILLIM RAJONAL - JUG  
REGIONALNA RAZVOJNA AGENCIJA - JUG  
BÖLGESEL KALKINMA AJANSI - GÜNEY  
REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY - SOUTH

### Tabela e pikëve

Kriteret e vlerësimit	Pikët
1. Historiku i biznesit dhe planet për të ardhmen	20
2. Kapaciteti operacional dhe financiar	15
3. Rëndësia e projektit, kreativiteti dhe tregu	30
4. Arritja e objektivave	15
5. Qëndrueshmëria e biznesit	10
6. Buxheti dhe objektivat financiare	10
<b>GJITHSEJ PIKË</b>	<b>100</b>

Për t'u para-selektuar, duhet të keni së paku 50% në secilin kriter të vlerësimit. Pas vlerësimit, aplikantët do të renditen sipas pikëve të fituara. Projektet me pikët më të larta do të zgjedhen përkohësisht deri në shpenzimin e buxhetit në dispozicion.

### 5. LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca A1 - Formulari i Aplikimit Lot 1

Shtojca A2 - Formulari i Aplikimit Lot 2

Shtojca B - Buxheti

Shtojca C1 - Projektioni financiar Lot 1

Shtojca C2 - Projektioni financiar Lot 2

Shtojca D - Deklarata e Aplikantit